

## **FAMILJA DAKO DHE KONGRESI I MANASTIRIT**

### *Nga promovimi i alfabetit te persekutimi në regjimin komunist*

**PHD (c) Dorina DAIU, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojave të Komunizmit,**  
**dorinadaiu@yahoo.com**

**Dr. Florinka GJEVORI, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**  
**florinkagjevori@yahoo.com**

**Msc. Helidon SOKOLI, helidon\_sokoli@drtkshkoder.gov.al**

#### **Abstrakt**

Ky artikull shqyrton rolin dhe fatin e familjes Dako pas Kongresit të Manastirit dhe përndjekjen e saj gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Kongresi i Manastirit i vitit 1908 ishte një moment vendimtar në historinë shqiptare, duke konsoliduar alfabetin e gjuhës shqipe dhe duke forcuar identitetin kombëtar. Familja Dako, përfaqësuar nga figura si Sotir Peci dhe Lef Nosi, dha një kontribut të rëndësishëm në këtë proces. Megjithatë, pas vendosjes së regjimit komunist, shumë pjesëmarrës të Kongresit, përfshirë edhe familjen Dako, u përballën me përndjekje për shkak të qëndrimeve të tyre demokratike dhe lidhjeve me Perëndimin. Artikulli analizon faktorët që çuan në persekutimin e tyre, veçanërisht ndikimin e familjes në arsimin dhe kulturën shqiptare. Theksohet se regjimi synoi të asgjësonte trashëgiminë e tyre si pjesë e përpjekjeve për të shtypur elitat kombëtare. Studimi bazohet në burime arkivore të pa publikuara dhe dëshmi familjare, duke kontribuar në ruajtjen e kujtesës historike përballë shtrembërimeve ideologjike.

***Fjalë çelës:** regjim komunist, dokumente, dosje hetimore, persekutim.*

#### **The Dako Family and the Monastery Congress**

##### *From promoting the alphabet to persecution under the communist regime*

#### **Abstract**

This article explores the role and fate of the Dako family following the Congress of Manastir and their persecution during the communist regime in Albania. The 1908 Congress was a decisive moment in Albanian history, consolidating the national alphabet and strengthening collective identity. The Dako family, represented by figures such as Sotir Peci and Lef Nosi, played a significant role in this historical process. However, after the establishment of the communist regime, many Congress participants, including members of the Dako family, faced political persecution due to their democratic orientation and ties to the West. The article examines the key factors that led to their repression, focusing on the family's influence in Albanian education and culture. It highlights how the regime aimed to erase their legacy as part of broader efforts to suppress national elites. The study draws on previously unpublished archival materials and family testimonies, offering a contribution to preserving historical memory in the face of ideological distortion and historical erasure.

***Keywords:** communist regime, documents, investigative files, persecution*

## Hyrje

Arsimi dhe emancipimi i femrës shqiptare nuk mund të kuptohet pa rolin dhe kontributin e motrave Qiriazi. Dy motrat Sevastia dhe Parashqevia Qiriazi, si drejtuese të Shkollës së Vashava në Korçë dhe si organizatore, qëndrojnë në krye të luftës për të vënë në jetë programin iluminist për arsimin e popullit tonë. Sipas një artikulli të Yll' i mëngjesit të botuar në 1930, "Zonja Sevasti është e para Shqipëtare që hyri të luftonjë si ushëtare për të ndrituar dhe për të naltësuar kobin e saj edhe për të mprojtur të drejtat e Shqipërisë"<sup>241</sup>. Si politikane dhe diplomate ato e përfaqësuan me dinjitet lëvizjen tonë kombëtare dhe mbrojtën me guxim para diplomacisë së Fuqive të Mëdha dhe forumeve ndërkombëtare kërkesat e shqiptarëve dhe të drejtat legjitime të popullit tonë. Në një memorandum dërguar Presidentit Amerikan Woodrow Wilson në 12 tetor 1918 Sevasti K Dako {...} kemi nderin t'ju dërgojmë Shkëlqesi, këtë deklaratë për të drejtat, shpresat dhe aspiratat e Shqipërisë dhe kokulur i lutemi Shkëlqesisë suaj të marrë përsipër këtë barrë të ndershme dhe të përdorë ndikimin e kombit tuaj të virtytshëm në Konferencën e Paqes, për të mbrojtur interesat jetike të kombit tonë pa miq, siç janë paraqitur në këtë memorandum {...}<sup>242</sup>.

Pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, familja Qiriazi dhe Kristo Dako (Nathanaili, 2016: 68) u vunë në shënjestër të autoriteteve. Shkolla e Vashava u mbyll dhe kontributi i tyre në arsimin dhe emancipimin shqiptar u mohua. Të gjitha veprat dhe arritjet e tyre u ndërprejnë me dhunë, dhe familja u përdoq për "aktivitet armiqësor". Kjo periudhë përfaqëson një nga kapitujt më tragjikë të historisë së familjes Qiriazi-Dako.

## Roli i familjes Qiriazi në dritën e kontekstit historik dhe organizimit të Kongresit

Në fund të shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX, gjuha shqipe ishte në një situatë të vështirë për shkak të mungesës së një alfabeti të unifikuar. Rilindasit me të drejtë e shihnin mungesën e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe jo vetëm si një problem gjuhësor e kulturor, por edhe si një çështje politike, një shenjë dasie, që pengonte bashkimin e Shiptëarëve.<sup>243</sup> deri në këto momente shqiptarët kanë pasur 6-7 alfabet pr 4 prej tyre ishin më të përdorshëm ku përmendim; Alfabetin e Stambollit, alfabetin e jezuitëve, alfabetin e Shoqërisë "Bashkimi" si dhe alfabetin e Shoqërisë "Agimi". Kongresi i zhvillon punimet më 14-22 nëntor 1908, ku pjesëmarrësit ishin; Sotir Peci Bukuresht; Dhimitër Buda Elbasan; Simon Shuteriqi Elbasan; Kamber Efendiu Elbasan; Lef Nosi Elbasan; Refik Beu Tiranë; Leonidha Naci Vlorë; Rauf Beu Gjirokastër; Fehmi Efendiu Gjirokastër, Naim Beu Gjirokastër; Cerciz Topulli Gjirokastër; Mit'hat Beu Janinë; Shfqet Beu Korçë; Thoma Avrami Korçë; Sami Beu Korçë; Grikor M Cilka Korçë; Mihal Gramenoja Korçë; Mehmed Emini Korçë; Ali Vasfiu Korçë; Selahedin Beu Manastir; Gjergj D.Qiriazi Manastir; Ibrahim Efendiu Shkup; Emin Beu Shkup; Haxhi Jashar Efendiu Shkup; Rrok Berisha Shkup; Akil Eftemiu Kostancë; Hilë Mosi Shkodër; Luigj Gurakuqi Shkodër; Mati Logoreci Shkodër; Atë Gjergj Fishta Shkodër, Dom Ndre Mjeda Shkodër; Serafedin Efendiu Shkodër; Luigj urakuqi Itali; Shahin Beu Kolonjë; Sulejman Efendiu Starovë; Adnan Shkaba Sofje; Dhimitër Mole Filipopolis; Nyzhet Beu Berat; Zejnel Beu Berat; Fehim Beu Egjipt; Atë Nikoll Kacorri Durrës; Azis Efendiu Bërzeshtë; Fahri Beu Resnë; Zejnel Beu Dishnicë; Maliq Elmazi Nikolec; Xhemal Beu Ohër; Beqir Dalipi Ohër; Sadullah Efendiu Mat; Ramiz Beu Dibër; Izet Beu Follorinë; Abdyl Beu Starje;

<sup>241</sup> Yll' i mëngjesit, vol. 1, nr.8, 30 prill 1917, f. 229-230

<sup>242</sup> ISShP, Jeta ime Sevasti Qiriazi-Dako, Tiranë 2022, f. 245

<sup>243</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Historia e Popullit Shqiptar", Toena, Tiranë 2002, f. 391

Sadik Efendiu Kërcovë.<sup>244</sup> Mit'hat Frashëri zgjidhet kryetar i Kongresit. Nën kryetare Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazi.<sup>245</sup> Në Kongresin e Manastirit ftohet për të marrë pjesë dhe Sevasti Qiriazi por për shkak të angazhimit shumë të madh në Shkollën Shqipe të vashave e kishte të pamundur për t'ju bashkuar punimeve të Kongresit kështu që në vend të saj nis motrën Parashqevinë. Në ditët e Kongresit ajo kishte ndihmuar të vëllanë, Gjergj Qiriazin, në dokumentimin e përditshëm të mbledhjeve dhe diskutimeve të rëndësishme aty.<sup>246</sup> Në ditën e tretë të punimeve Kongresi për shkak të mos-dakortësisë në caktimin unanim alfabetit delegatët u morën vesh që do të zgjidhej një Komision i cili do të vendoste për çështjen e alfabetit. Komisioni përbëhej nga 11 anëtarë dhe zgjedhja e alfabetit do të bëhej me votim të fshehtë. Këta u zgjodhën si anëtarë;<sup>247</sup>

- |                         |                         |
|-------------------------|-------------------------|
| 1) At Fishta            | 7) Dom Mjeda            |
| 2) Luigj Gurakuqi       | 8) Gjergj D. Qiriazi    |
| 3) Sotir Peci           | 9) Fehmi Efendi Topulli |
| 4) Mit'hat Bej Frashëri | 10) Nyz-het Bej Vrioni  |
| 5) Shahin Kolonja       | 11) Grigor M. Cilka     |
| 6) Dhimitër Buda        |                         |

Gjatë kongresit, delegatët shqyrtuan disa propozime alfabetike, duke u bazuar në kritere si thjeshtësia, lehtësia e përdorimit dhe përputhshmëria me traditat shqiptare. Më 22 nëntor, kongresi miratoi dy alfabete: alfabetin e Stambollit, i cili ishte në përdorim që prej vitit 1879, dhe një version të ri të alfabetit latin, që më pas u bë alfabeti zyrtar i shqipes.

### **Persekutimi i familjes Sevasti Qiriazi Dako: Historia e një familjeje nën shtypje dhe represion**

Ka raste të rralla në historinë e popullit shqiptar, veçanërisht në periudhën tonë Rilindja Kombëtare, kur anëtarët e një familjeje hynë si veprimtarë aktivë të shqiptarëve Lëvizjes Kombëtare, të cilët i kushtuan të gjithë potencialin e tyre moral, material, shpirtëror dhe intelektual çështjes kombëtare, si në planin çlirimtar, ashtu edhe në atë kulturor e arsimor, si familja Qiriazi e Manastirit, e cila i dha kombit pesë intelektualë: Gjerasim, Gjergj, Kristo, Sevastia dhe Parashqevia.<sup>248</sup> Pavarësisht kontributit të tyre të madh, në fund të Luftës së Dytë Botërore kur në pushtet vijnë Komunistët, udhëheqësi i tyre Enver Hoxha nis një spastrim të madh politik, ekonomik, social, kulturor, fetar. Për familjen Qiriazi viti 1946 ishte fillimi i një kalvari të gjatë vuajtjesh. Në janar të 1946 u vjen një urdhër për sekuestrimin e godinës së shkollës dhe dëbimin e tyre nga Kamza. Sevastia dhe Parashqevia nuk qëndrojnë duarkryq para këtij urdhri. Më anë të një letre e 21, gusht-it 1945, drejtuar KANÇ-së pas sekuestrimit të Institutit Kyrias nga drejtoria e mbrojtjes së popullit vinte theksin se kishin mbetur pa strehim dhe pa mjete jetese. { ...Çështja qëndron kështu; neve rrojmë me prodhimet e tokës tonë të paktë të cilën e punojmë vetë dhe me ato të pakëta kafshë që na mbetnë -prandaj është e pamundur të transferohemi në qytet dhe afër nesh nuk gjinet as vend dhe as shtëpi të përshtatshme Bibliotekën ku ta vendosim. Neve të dy motrat, që besoj se ishim nga të parat në Shqipëri që kuptuam rëndësinë të organizimit të Gruas Shqiptar edhe të edukatës së vajzës shqiptare dhe më 1891 cëlëm shkollën e parë shqipe kombëtare për vajza në kohën e tmerrit të

<sup>244</sup> Lloshi Xhevat, "Gjergj Qiriazi veprimtaria dhe vepra", ISShp, 2022, f. 424-426

<sup>245</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Historia e Popullit Shqiptar", Toena, Tiranë 2002, f. 392

<sup>246</sup> Toska Teuta, "Parashqevi Qiriazi dhe viti I saj 1919", Tiranë, 2020, f. 2

<sup>247</sup> Lloshi Xhevat, "Gjergj Qiriazi veprimtaria dhe vepra", ISShp, 2022, f. 432

<sup>248</sup> Kecmezi Basha Sabile, "*Qiriazët: Familje patriotike dhe atdhetare*", (Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve – 110– vjet alfabet shqip, 2018), 386.

Sulltan Hamitit...} <sup>249</sup>. Kërkesa dhe lutja e tyre nuk merret parasysh nga regjimi dhe ata detyrohen të strehohen në një banesë të shërbëtores së tyre besnike në kushte ekstremisht të vështira. Po këto vështirësi nuk ishin asgjë po t'i krahasojmë me ato që Sevastia do të kalojë në vitet e mëvonshme.

Në fund të vitit 1946 Sigurimi i Shtetit filloi të merrte në pyetje çdo natë Aleksandrin dhe Gjergjin me shpresë që t'i futnin në një grup armiqësor. <sup>250</sup> Viti 1945 e gjeti Dr. Gjergj Dakon djalin e Sevastisë në detyrën e mjekut kirurg në Kuçovë dhe më 17 dhjetor u caktua nga Ministria e Shëndetësisë në shërbim të UNRRA-s. Në gusht të vitit 1946 emërohet në Spitalin e Vlorës, ku arrestohet sikundër i vëllai Skënderi. Sigurimi e përfshin në grupin tekniko-intelektual të Kuçovës bashkë me Ing. Alizotin e Zuberin. <sup>251</sup> Djali i vogël i patriotëve Kristo Dako dhe Sevasti Qiriazzi, Aleksandër Dako arrestohet më 15 mars 1947. Pas torturash të tmerrshme në hetuesi Gjergj Kristo Dako ndërron jetë. Regjimi i egër hoxhian del me një njoftim të Drejtorisë së Sigurimit Shtetit { ... Ju njoftojmë se dje më datë 18.II. 1949, u vetë var i para-burgosuri Gjergj Dako i cili ndodhesh i izoluar në një nga birucat e reja të burgut Arm. Te Popullit... } <sup>252</sup>



<sup>253</sup>Foto 1; *Gjergj Kristo Dako i varur në Hetuesi.*

Nga foto e siguruar nga pasardhësit e familjes Dako shikohet që biruca është aq e ulët saqë nuk të jep mundësinë e një vetëvrasjeje siç regjimi komunist deklaroi vdekjen e tij. { ...Ma vonë kur Roja shkoi tek I burgosuri për t'i dhënë barna që t'i pinte mbasi ishte pak i sëmur, e shtyn derën e birucës ku ishte i burgosuri por dera nuk hapesh, sheh nga deriçka shikon se trupi bjen dhe hapet dera;

hyn Roja Brenda sheh se ai ishte varur këllëfin e dyshekut të cilin e kishte përdredhur në formë litari e kishte futur menteshën e derës nga brenda me qëllim që të mos diktohesh nga Roja... } <sup>254</sup> Sevastia mundi të zbulonte se ata që vdisnin në burg çoheshin në Lumin e Tiranës. Niset së bashku me Marian, bashkëshorten e Gjergjit në kërkim të trupit të të birit dhe arrijnë ta gjejnë atë. Ndërkohë po gdhinte mëngjesi dhe kishin frikë se mos dikush i diktonte, kështu që ato e fshehën trupin në anë të tokës dhe u kthyen në shtëpi, me qëllim që të ktheheshin në mbrëmje dhe të merrnin trupin e tij. <sup>255</sup> Kur kthehen të nesërmen trupin e Gjergjit nuk e gjejnë.

Pas humbjes së jetës së djalit 36 vjeçar ajo kurrë nuk u dorëzua duke kërkuar trupin e tij. Çdo ditë që kalonte aq më tepër rritej dëshpërimi i saj dhe më 1949 ndërron jetë. Nuk arritur të shikojë dhe djalin e saj të madh që dergjej i paralizuar në burg. Aleksandër Dako { ...arrestohet në 28 Nëntor 1946, me rekursin ankimor date 7/Maj/1949 ka deklaruar kundra vendimit Nr. 58 datë 5/Maj/ 1949 të Gjykatës Ushtarake Tiranës, me te cilin është dënuar me 7 (shtate) vjet privim lirie e punë të Detyruar dhe

<sup>249</sup> F.490-1945-373, f. 1

<sup>250</sup> ISShP, Jeta ime Sevasti Qiriazzi-Dako, Tiranë 2022, f. 241

<sup>251</sup> AISKK, F 1. V 2013. D. 5/1. Fl. 310-311.

<sup>252</sup> AMPB, Fondi operativ, d. 409, fl. 3.

<sup>253</sup> Foto marrë nga Arkivi i familjarëve Dako

<sup>254</sup> AMPB, Fondi operativ, d. 409, fl. 3.

<sup>255</sup> ISShP, Jeta ime Sevasti Qiriazzi-Dako, Tiranë 2022, f. 241

humbjen e të drejtave civile për 1 vit ...} <sup>256</sup> do të lirohet në vitin 1953. Pasi u mori prona, burgosi, vrau anëtarë të kësaj familje të nderuar Sistemi Hoxhian do të tregojë një vëmendje të veçantë me rastin e 50 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Aty në Vlorë, ku 50 vjet më parë u shpall pavarësia e Shqipërisë, katër pjesëtarë të familjes Qiriazi – Gjergji, Sevastia dhe Parashqevia - u dekoruan me urdhrin e Lirisë dhe urdhrin për "Veprimtari patriotike" <sup>257</sup>. Parashqevia do ta kalojë jetën e saj pranë familjes së Aleksandrit deri në vitin 1970 ku do të ndërrojë jetë.

### Konkluzione

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë rolin e rëndësishëm që ka luajtur familja Qiriazi-Dako gjatë dhe pas Kongresit të Manastirit dhe përjetimin e persekutimit të saj gjatë regjimit komunist. Kongresi i Manastirit, i mbajtur në vitin 1908, ishte një ngjarje kyçe për historinë e Shqipërisë, pasi u miratua alfabeti i gjuhës shqipe dhe u shpallën parimet themelore për zhvillimin e kulturës dhe arsimit shqiptar. Pas këtij kongresi, shumë figura të njohura të kombit, përfshirë ata të familjes Dako, kontribuan në arsimimin dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Anëtarët e familjes Dako ishin të njohur për angazhimin e tyre në fushën e arsimit dhe të lëvizjeve kombëtare, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar në periudha të vështira. Persekutimi i familjes Dako gjatë regjimit komunist ishte një periudhë e vështirë dhe e errët për shumë anëtarë të kësaj familjeje. Ata u burgosën, u internuan, ose u dënuan për qëndrimet dhe aktivitetet e tyre që regjimi i asaj kohe i konsideronte si të rrezikshme për stabilitetin e tij. Ky persekutim ndikoi jo vetëm te pjesëtarët e familjes Dako, por edhe te ruajtja e vlerave kulturore dhe historike shqiptare, duke i shkatërruar ndjeshëm mundësitë për zhvillimin dhe promovimin e identitetit kombëtar në një periudhë të errët për Shqipërinë. Nëpërmjet analizës së periudhës së persekutimit, ky punim synon të theksojë pasojat që pati kjo periudhë për familjen Dako, për të kuptuar se si lufta për ruajtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar është ndërprerë dhe cenuar nga regjimi komunist, duke sjellë pasoja të rënda për ata që ndihmuan në ndërtimin e kulturës shqiptare modern

### Referenca

- F. 490-1945-373, f. 1  
AISKK, F 1. V 2013. D. 5/1.  
AMPB, Fondi operativ, d. 409  
AMPB, F.1, D. 802,  
Foto marrë nga Arkivi i familjarëve Dako  
Yll' i mëngjezit, vol. 1, nr.8, 30 prill 1917  
Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002). *Historia e popullit shqiptar*. Tiranë: Toena.  
Instituti i Studimeve Shqiptare dhe Protestante (ISShP). (2022). *Jeta ime – Sevasti Qiriazi-Dako*. Tiranë: ISShP.  
Këçmezi-Basha, S. (2018). *Qiriazët: Familje patriotike dhe atdhetare*. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – 110-vjetori i alfabetit të shqipes.  
Lloshi, Xh. (2022). *Gjergj Qiriazi: Veprimtaria dhe vepra*. Tiranë: ISShP.  
Nathanaili, V. (2016). *Rruga e mundimshme e shkollës shqip: Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912–1944*. Tiranë: UET Press.  
Toska, T. (2020). *Parashqevi Qiriazi dhe viti i saj 1919*. Tiranë: [Botuesi mungon – nëse dihet, mund të shtohet].

<sup>256</sup> AMPB, F.1, D. 802, fl. 11.

<sup>257</sup> ISShP, Jeta ime Sevasti Qiriazi-Dako, Tiranë 2022, f. 241